



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:251037

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506403

P.nr.16/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me zyrtaren ligjore Mirjeta Meha - Muli, në çështjen penale kundër të pandehurit A.K nga Vushtrria, për shkak të veprës penale *Detyrimi në tentativë* nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-se sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.1253/23 të dt.24.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar - seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 20.03.2024, në praninë e Prokurores së Shtetit Albana Parduzi, të pandehurit A.K dhe mbrojtësit me autorizim av.Agim Lushta, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 20.03.2024, me datë 26.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.K nga i ati S., e ëma H., e vajzërisë H., i lindur më ... komuna e Vushtrrisë, tani me vendbanim në Vushtrri, me numër personal ..., i punësuar, pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës, i martuar, prind i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Në muajin Qershor të vitit 2023 në "H..." - Vushtrri, i pandehuri A.K, me dashje, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka kanosur seriozisht të dëmtuarin B.F dhe nënën e tij të dëmtuarën Z.F, me qëllim që të njëjtët të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, në atë mënyrë që përmes telefonit ka kontaktuar të dëmtuarin B.F, i cili është ish i fejuari i motrës së të pandehurit L.K, ku përmes telefonit, i është drejtuar me fjalët: "*Nëse nuk i bjen 30.000 mijë euro, je në bele ti, nena jote dhe vëllau yt, por nëse i paguan brenda dy muajve këto para atëherë jemi në rregull*", të cilat para ka kërkuar që ti sjell e dëmtuara Z. tek motra e të pandehurit L., për arsye kinse se i dëmtuari B.F, për kundër faktit që kishte qenë i fejuar me motrën e tij, ende nuk kishte arritur ta merrte për të bashkëjetuar në Finlandë, nga një situatë e tillë ishte ndjerë e frikësuar e dëmtuara-ankuesja Z.F dhe rastin e kishte lajmëruar në polici, nga çka vepra penale ka mbetur në tentativë,

- Me këtë ka kryer veprën penale *Detyrimi në tentativë* nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 44, 69, dhe 70 dhe nenit 328 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe nenit 230, 364, 449, 452 dhe 460 të KPPK-së,

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: A.K i shqipton DËNIM MË BURG në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, më pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim i është zëvendësuar në DËNIM ME GJOBË, në shumën prej njëmijë e dyqind (1,200) euro, dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej katërqind (400) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Palët e dëmtuara kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëqind (100) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave shumën prej njëzet (20) euro në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1253/23 e datës 24.01.2024, kundër të pandehurit A.K, nga fshati Vushtrria, për shkak të veprës penale *Detyrimi në tentativë* nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, së bashku me aktakuzën e lartcekur kanë dorëzuar edhe Marrëveshjen për Pranimin të Fajësisë PP.II.nr.1253/23 të datës 24.11.2023, të lidhur në mes të akuzuarit A.K dhe Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar – seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 20.03.2024, ku në pajtim me dispozitat e nenit 230 të KPPK-së, ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ku ka dëgjuar prokuroren e shtetit Albana Parduzi, të akuzuarin A.K, si dhe mbrojtësin av.Agim Lushta.

Prokurorja e Shtetit në shqyrtimin fillestar - seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se: Prokuroria, pas kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit dhe të pandehurit, ka shqyrtuar mundësinë për arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë lidhur me rastin PP.II.nr.1253/23. Konsiderojnë që marrëveshja është e arritur në përputhje me dispozitat e KPPK-së, përkatësisht nenit 230 të KPPK-së. Andaj, mbi bazën e kësaj, duke respektuar vullnetin e palëve, i ka propozuar gjykatës që marrëveshjen e arritur, së bashku me dënimin e rekomanduar ta aprovojë në tërësi dhe se i njëjti dënim i plotëson të gjitha kushtet në përputhje me pasojën e shkaktuar dhe të arritur me vullnetin e palëve.

Mbrojtësi i të pandehurit, av.Agim Lushta në shqyrtimin fillestar - seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se: Mbrojtja i ka sqaruar të pandehurit mjaftueshëm natyrën e pranimin të fajësisë dhe i njëjti ka kuptuar benefitet dhe pasojat

e pranimit të fajësisë. Marrëveshja e arritur në prokurori është në pajtim me dispozitat ligjore të KPRK-së dhe si e tillë, i plotëson kushtet sa i përket dënimit të rekomanduar me dënim me burgim prej 4 muaj si dhe dënim me gjobe në shumën prej 400 Euro ku i ka propozuar gjykatës që dënimin me burg ta shndërroj në dënim me te holla, pasi që konsiderojnë se me këtë do të realizohet qëllimi i dënimit.

I pandehuri në shqyrtimit fillestar - seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se: i propozon gjykatës të aprovohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë në kushte dhe rrethana, ashtu siç është përshkruar në marrëveshje si dhe dënimi me burg të zëvendësohet me dënim me gjobë.

Gjykata pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Mitrovicë me numër PP.II.nr.1253/23 të dates 24.11.2023, e cila ka të bëjë me të akuzuarin A.K, për shkak të veprës penale *Detyrimi në tentativë* nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si dhe deklarimit për pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari në pajtim me dispozitat e nenit 230 par.18 të KPPRK-së, gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vet i akuzuari dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par.1 dhe 2 të KPPK-së për pushimin e procedurës, përkatësisht hudhjen e aktakuzës, prandaj gjykata ka konstatuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.21 të KPPRK-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

Prandaj, gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, duke gjetur se me të vërtetë i akuzuari ka kryer veprën penale ashtu siç përshkruhen në aktakuzë dhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij, ashtu që për këtë veprë penale është paraparë dënimi me burgim dhe dënim me gjobë, ku sipas marrëveshjes, gjykata i shqiptoj dënimin me burgim prej katër (4) muaj, të cilin dënim me pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 44, dënimin me burgim ia zëvendëson në dënim me gjobë në shumën prej një mijë e dyqind (1,200) euro, dhe dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400) euro.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit. Ashtu që për të akuzuarin, si rrethana lehtësuese gjeti pranimi i fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, se i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, faktin se vepra ka mbetur në tentativë, pendimin dhe premtimin e të

akuzuarit se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 KPRK-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën e kryer penale dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimin për pjesën se palët e dëmtuara kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 par.1 të KPPK-së, pasi që të dëmtuarit përmes deklaratave të tyre, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të sjellura së bashku me aktakuzën nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 par.1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.16/24, datë 26.03.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën..